

VENDIM
Nr. 46, datë 1.2.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR TRANSPORTIN UJOR
NDËRKOMBËTAR NË LIQENIN E OHRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për transportin ujor ndërkombëtar në liqenin e Ohrit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR UJOR NË LIQENIN E OHRIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme “Palët”),

me qëllim të zhvillimit të marrëdhënieve miqësore midis dy shteteve dhe të forcimit të bashkëpunimit në bazë të parimit të lundrimit të lirë në fushën e transportit të brendshëm ujor përmes liqenit të Ohrit, duke pasur parasysh parimet e barazisë, të bashkëpunimit reciprok dhe të përfitimit reciprok;

duke pasur parasysh dhe duke respektuar parimet e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare dhe veçanërisht me konventat ndërkombëtare të detyrueshme për palët në marrëveshje, ranë dakord siç vijon:

Neni 1
Përkufizime

1. Termi “anije” do të thotë anije tregtare që lundron nën flamurin e cilësdo palë, të regjistruar në territorin e shteteve, përkatësisht palëve në marrëveshje dhe kryen transport ndërkombëtar: ky term gjithashtu nënkupton edhe anije tregtare të palës së tretë, flamuri i së cilës është i pranueshëm për të dyja palët në marrëveshje, me kusht që të jetë në përputhje me praktikën, politikën dhe legjislacionin e secilës palë në marrëveshje.

Megjithatë, termi nuk përfshin:

- a) luftanije dhe mjete të tjera lundrimi në shërbim të forcave të armatosura;
- b) mjete lundrimi shkencore-hulumtuese;
- c) anije peshkimi; dhe
- d) mjete lundrimi që kryejnë funksione qeveritare, anije spitalore dhe anije të tjera që kryejnë detyra jotregtare.

2. Me termin “anëtare të ekuipazhit” nënkuptohen kapiteni dhe të gjithë të tjerët të punësuar në anije, në detyra dhe shërbime që kanë të bëjnë me drejtimin e anijes, duke pasur një dokument identifikimi të detarit, në përputhje me nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje, dhe të cilët janë përfshirë në listën e ekuipazhit.

3. Termi “kompani transporti” do të thotë person juridik, i regjistruar në territorin e shtetit - palë në marrëveshje, që ka drejtori dhe menaxhim të vetin në territorin e shtetit që është palë në marrëveshje, menaxhon anijet dhe kryen transport ujqor ndërkombëtar.

4. Termi “port i palës” do të thotë çdo port ose objekt në territorin e palës që përdoret për transport ndërkombëtar për ngarkim dhe shkarkim mallrash dhe/ose pasagjerësh nga ajo palë.

5. Me termin “autoritet kompetent” nënkuptohet:

a) për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë - Ministria e Infrastrukturës dhe Energetikës;

b) për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut — Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve.

Neni 2

Liria në komunikacion dhe mosdiskriminimi

1. Të dyja palët bien dakord të vazhdojnë dhe të mbajnë linjën e transportit përmes liqenit të Ohrit në kalimin kufitar të Shën Naumit dhe të Pogradecit.

2. Një anije e njëres palë do të ketë të drejtë të kryejë transportin detar midis porteve të të dyja palëve të hapura për lundrim.

3. Të dyja palët në marrëveshje do të inkurajojnë: autoritetet e tyre kompetente, si dhe kompanitë e anijeve dhe organizatat në aspekte të ndryshme të bashkëpunimit, duke i përfshirë, por pa u kufizuar në këto çështje:

a) përbushjen e kërkesave të transportit ndërkombëtar në rrugë ujore si dhe përdorimin e plotë dhe efikas të porteve të flotës detare dhe të të dyja palëve;

b) garantimin e sigurisë në lundrim, duke përfshirë garantimin e sigurisë së anijes, të anëtarëve të ekuipazhit, të ngarkesës, të pasagjerëve dhe të mbrojtjes së mjedisit;

c) ngritjen e nivelit të mbrojtjes së turizmit;

d) zhvillimin e transportit të brendshëm ujqor;

e) forcimin e kontakteve në fushën e shkencës, të teknologjisë së transportit të brendshëm ujqor dhe shkëmbimin e përvojës së fituar.

Neni 3

Trajtim i barabartë i mjeteve të lundrimit

1. Çdo palë në marrëveshje mund të sigurojë trajtim të njëjtë të anijeve të palës tjetër vetëm në pjesën e nisjes dhe të zbarkimit të pasagjerëve.

2. Midis territoreve shtetërore të palëve në marrëveshje, transporti i pasagjerëve kërkon verifikim paraprak nga autoritetet kompetente, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga legjislacioni nacional.

Neni 4

Masa për lehtësimin e transportit ujqor

1. Palët në marrëveshje do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit të tyre ekzistues për të lehtësuar kryerjen e transportit, për të parandaluar pengesat e paarsyeshme të anijeve dhe, aq sa është e mundur, për të përshpejtuar dhe thjeshtuar plotësimin e procedurave të patjetërsueshme doganore/ekonomike në kalimet kufitare dhe formalitetet e tjera në porte.

2. Pronari i anijes, dy orë para nisjes dhe pas mbërritjes, autoriteteve kompetente do t'u dorëzojë:

- a) deklaratë të përgjithshme;
- b) deklaratë të ngarkesës;
- c) deklaratë të dyqanit;
- d) deklaratë të efikasitetit të ekuipazhit;
- e) listë të ekuipazhit;
- f) listë të pasagjerëve;
- g) formular njoftimi për dërgimin e mbeturinave në objektet pranuese.

Neni 5

Dokumente për pasagjerët

Të dyja palët bien dakord se shtetasit e secilës palë, që kanë dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, do të hyjnë dhe largohen nga territori i vendkalimit të caktuar kufitar të palës tjetër, në përputhje me legjislacionet nacionale përkatëse.

Neni 6

Dokumente për anije

1. Secila palë në marrëveshje do t'i njohë certifikatat dhe dokumentet e tjera të lëshuara nga pala tjetër në marrëveshje për mjetet e tyre të lundrimit.

2. Anijet e cilësdo palë në marrëveshje që i kanë certifikatat e tonazhit të lëshuara në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të Matjes së Tonazhit të Anijeve të vitit 1969 dhe të njohura nga pala tjetër në marrëveshje, nuk do të jenë subjekt i matjes sërish të tonazhit në portin e palës tjetër në marrëveshje. Gjithashtu, taksat në port, që sipas rregullës, llogariten sipas tonazhit të anijes, u nënshtrohen pagesës mbi bazën e të dhënave të certifikatës së tonazhit të lartpërmendur.

3. Secila palë në marrëveshje mban të drejtën për të kryer inspektimin e anijes, me kusht që të ketë dyshim të arsyeshëm për mospërputhje midis informacionit të dhënë në certifikatat dhe të dhënave aktuale të anijes. Në këtë rast, kontrollimi i anijes bëhet në përputhje me legjislacionin nacional.

Neni 7

Veprimtari tregtare

Një kompani transporti e cilësdo palë në marrëveshje ka të drejtë të themelojë përfaqësi dhe/ose ekspoziturë dhe/ose filial në territorin e shtetit të palës tjetër në marrëveshje, në përputhje me legjislacionin nacional të së dytës, për të ofruar shërbime në transportin ujor dhe në sferat që lidhen me të dhe në punë të dërgojë përfaqësuesit dhe personelin e saj në territorin e shtetit të palës tjetër në marrëveshje.

Neni 8

Incidente gjatë udhëtimit

1. Në qoftë se anija e cilësdo palë në marrëveshje pëson çfarëdo dëmi ose incident në ujërat territoriale të palës tjetër në marrëveshje, pala e parë në marrëveshje menjëherë do njoftojë autoritetet kompetente përkatëse të palës tjetër në marrëveshje si më poshtë:

- a) t'i njoftojë përfaqësitë diplomatike ose konsullore të palës tjetër në marrëveshje;
- b) t'ia japë ndihmën e nevojshme anijes, ekuipazhit të saj dhe ngarkesës dhe të ofrojë të njëjtin trajtim që u është dhënë anijeve të saj nacionale.

2. Palët në marrëveshje do të bashkëpunojnë në hetimin e këtyre aksidenteve siç parashikohet me kodeksin e IMD-së për hetimin e dëmeve dhe të incidenteve detare të miratuara me rezolutën A. 848(20) e IMO-s, siç është ndryshuar, përveç nëse palët në marrëveshje nuk kanë rënë dakord ndryshe.

3. Në qoftë se anija e cilësdo palë në marrëveshje pëson dëme në territorin e shtetit të palës tjetër në marrëveshje, ngarkesa, rezervat dhe mallrat e tjera të saj, me kusht që të mos dërgohen për përdorim ose konsum në territorin e shtetit të palës tjetër në marrëveshje, në këtë rast Pala në marrëveshje do të lirohet nga çfarëdo lloj tatimesh.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk zbatohen për legjislacionin që ekziston në territorin e shteteve të palëve në marrëveshje, që përcakton rregullat e ruajtjes së përkohshme të ngarkesës.

Neni 9

Dokumente të udhëtimit për anëtarët e ekuipazhit

1. Çdo palë në marrëveshje do t'i njohë dokumentet personale të anëtarëve të ekuipazhit, të lëshuara në mënyrë të rregullt nga autoritetet kompetente të palës tjetër në marrëveshje.

Këto dokumente do të jenë:

a) për anëtarin e ekuipazhit të anijes që lundron nën flamurin e Republikës së Shqipërisë, "Librezë anijeje".

b) për anëtarin e ekuipazhit të anijes që lundron nën flamurin e Republikës së Maqedonisë së Veriut "Librezë anijeje".

2. Për anëtarin e ekuipazhi, i cili është shtetas i një pale të tretë dhe është i punësuar në anijen e njëres prej palëve në marrëveshje, dokumenti i identifikimit është dokument i lëshuar nga autoritetet kompetente të palës së tretë, me kusht që të konsiderohet i mjaftueshëm sipas legjislacionit të palës tjetër në marrëveshje, të jetë i njohur si dokument identifikimi ose një dokument i barasvlershëm me të.

3. Palët në marrëveshje do t'i shkëmbejnë gjedhet e dokumenteve të identifikimit të anëtarëve të ekuipazhit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën për çfarëdo ndryshimi, duke dërguar gjithashtu edhe kopje, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 10

Harmonizim i dispozitave ligjore

1. Anija, anëtarët e ekuipazhit dhe pasagjerët e cilësdo palë në marrëveshje do t'i respektojnë ligjet e palës tjetër në marrëveshje, derisa anija është në ujërat ose në portin e palës tjetër në marrëveshje.

2. Kapiteni i anijes nuk do të lejojë persona të tjerë të hyjnë në anije jashtë kalimit kufitar, përveç gjatë operacioneve të shpëtimit.

3. Kapiteni i anijes nuk do të ketë kontakte me mjete të tjera të lundrimit gjatë udhëtimit, përveç anijeve të policisë, të doganës, të shërbimeve të sigurisë dhe të autoritetit të portit.

4. Pasagjerët janë të detyruar që, autoriteteve doganore, t'ua tregojnë bagazhin e tyre personal.

Neni 11

Konsultime

Me kërkesë të autoriteteve kompetente të cilësdo palë në marrëveshje, përfaqësuesit e autoriteteve kompetente të palëve në marrëveshje mund të takohen me njëri-tjetrën dhe të shqyrtojnë kushtet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Data dhe vendi i mbledhjeve të këtilla do të përcaktohen që më përpara.

Neni 12
Zgjidhje e kontesteve

Çdo kontest që buron nga zbatimi ose interpretimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet midis palëve nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave midis tyre.

Neni 13
Detyrime ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, e që dalin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, të cilave Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut janë palë.

Neni 14
Amendamente

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me pëlqimin e përbashkët të Palëve, me shkrim ndërmjet palëve në marrëveshje, ndërkaq ndryshimet ose plotësimet do të konsiderohen si pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje, ndryshime ose plotësime të cilat do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15
Shfuqizim i Marrëveshjes

Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “Për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore të udhëtimit Pogradec–Ohër, e nënshkruar më 26 shtator 1999, në Ohër, do të shfuqizohet ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës Palët e njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe mbeten të vlefshme për pesë vjet, rinovohen automatikisht për një periudhë ose periudhë tjetër të ngjashme dhe do të mbeten në fuqi, përpos nëse njëra palë në marrëveshje nuk e njofton palën tjetër në marrëveshje, me shkrim, për qëllimin e saj për të zgjidhur këtë Marrëveshje. Marrëveshja do të zgjidhet pas gjashtë muajsh, me pranimin e njoftimit të tillë nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Bashkëngjitur janë, komisionarët e lartpërmendur ose të poshtëpërmendur dhe të autorizuarit nga qeveria e tyre përkatëse që kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E përpiluar në Shkup, më datë 14 nëntor 2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze. Të gjitha tekstet janë barazisht autentike. Në rast dallimesh në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga palët, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Belinda Balluku
ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bllagoj Boçvarski
MINISTËR I TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE